

Abstrakti

Zbatimi i dënimeve alternative është një mundësi që u jepet personave në konflikt me ligjin për tu riintegruar në shoqëri si qytetarë për të jetuar një jetë të denjë. Dënimet alternative ndaj dënimit me burgim janë pjesë e reformave të mëdha që u referohen standarteve të trajtimit të të dënuarve me burgim. Këto reforma nuk janë vetëm një kërkesë e Këshillit të Evropës, Komitetit kundër Torturës, por janë edhe nevojë e domosdoshme. Janë tri pika në të cilat kjo reformë ligjore referon. E para është komponenti social, pra, si do të trajtohen dhe konsiderohen të dënuarit-ata nuk do të jenë më si kategoria që duhen të ndëshkohen nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe shoqëria duhet ti risocializojë. Komponenti i dytë është ai ligjor ndryshimet bëjnë të mundur që të gjitha këto ndryshime që ofrojnë alternativa të jenë të aplikueshme nga sistemi gjyqësor, prokuroria, si dhe nga ata që do të merren me ekzekutimin. Komponenti i tretë është një komponent financiar, ku me aplikimin e dënimit me kusht automatikisht sjellë uljen e kostove, por edhe përfitime të mëdha shoqërore.

Dënimet alternative janë mënyra më e drejtë për ti dhënë kuptim praktik idealit rehabilitues në aspektin penal dhe kriminologjik janë mënyra më efektive për të parandaluar recidivzmin dhe për të shmangur infektimin kriminal në burgje, në aspektin social dhe psikologjik ndihmojnë të dënuarin për të mbajtur lidhjet me familjen, punën dhe ambientin shoqëror dhe për të shmangur traumën psikike që shkakton burgimi, në aspektin ekonomik ulin barrën e shoqërisë për të mbajtur të burgosurit , duke i orientuar këto fonde drejt programeve të parandalimit, përmes edukimit, përkrahjes sociale, punësimit, mjekimit etj. Në planin njerëzor rrisin respektin për dinjitetin e njeriut dhe për patjetërsueshmërinë e kësaj të drejte themelore, andaj rekomandoj që gjykata duhet të aplikojë më shumë dënime alternative, me qëllim arritjen e qëllimit të rehabilitimit dhe riedukimit të të dënuarit, por edhe shkurtimit të shpenzimeve dhe uljes të numrit të burgosurve nëper burgje.